

Asistenca Financiare: Trinity Health angazhohet të ofrojë kujdes, trajtim dhe shërbime ndaj të gjithë atyre që vijnë tek ne për shkak të nevojave mjekësore.

Politika e Asistencës Financiare

- Ndihami financiare jepet në bazë të tē ardhurave tuaja. Kjo përcaktohet duke përdorur [udhëzimet e Nivelit Federal për Varférinë](#).
- Nëse fitoni [200]% ose më pak sipas udhëzimeve Federale për Nivelin e Varférisë, mund tē përfitonit një zbritje tē plotë. Kjo vlen për shërbimet e nevojshme mjekësore.
- Nëse fitoni ndërmjet [201]% dhe [400]% tē Nivelit Federal për Varférinë, mund tē përfitonit një zbritje tē pjesshme.
- Trinity Health nuk do t'i tarifojë pacientët e kualifikuar më shumë se norma e zbritjes së Medicare.
- Mund tē përfitojnë ulje sigurimet shëndetësore, bashkësigurimet dhe shpenzimet e zbritshme që ju keni. Ju mund tē kualifikoheni për ndihmë nëse fitoni më pak se [400]% tē Nivelit Federal për Varférinë.
- Nëse jeni duke u përballur me kosto si pasojë e rrethanave tē jashtëzakonshme, mund tē përfitonit ulje. Kjo ndodh kur shpenzimet tuaja mjekësore për 12 muajt e fundit janë mbi 20% tē tē ardhurave tuaja tē familjes. Ulja mund tē përfshijë edhe siguracionet shëndetësore. Mund tē përfshijë gjithashtu bashkësigurimin dhe shpenzimet e zbritshme.

Shgyrtoni Udhëzimet
Federale për Nivelin e
Varférisë këtu



<https://aspe.hhs.gov/topics/poverty-economic-mobility/poverty-guidelines>

Shërbimet me zgjedhje tē tilla si kirurgjia estetike nuk janë tē përshtatshme për asistencë financiare.

Për tē aplikuar për asistencë financiare, plotësoni dhe dorëzoni aplikimin. Politika e Asistencës Financiare të Trinity Health dhe Aplikimi janë tē disponueshme në faqen e internetit të spitalit. [Apply Now | Mount Carmel Health System](#) Ju gjithashtu mund tē kérkonit një kopje falas tē politikës dhe aplikimit duke ardhur vetë, me postë ose duke telefonuar vendin ku keni marrë përkujdesjen ose duke kontaktuar Trinity Health Enterprise Patient Financial Services, 20555 Victor Parkway, Livonia, MI 48152, numër pa pagesë në 800-494-5797 .

Politika e Asistencës Financiare të Trinity Health, Aplikimi dhe Përbledhja në Gjuhë tē Thjeshtë janë përkthyer në gjuhë tē tjera dhe ofrohen duke kontaktuar spitalin ose departamentin e Shërbimet Financiare për Pacientët ("Patient Financial Services") tē listuara më sipër.

Listë e ofruesve tē shërbimit: Listë e ofruesve tē shërbimit që japid kujdes mjekësor urgjent ose kujdes tē nevojshëm mjekësor në godinën spitalore, tē cilët mbulohen nga Politika e Asistencës Financiare tē spitalit, është në dispozicion në internet ose kur kérkohet.

Planet e pagesave afatshkurtra dhe afatgjata: Nëse nuk mund tē paguani pjesën tuaj, mund tē kualifikoheni për plane pagesë afatshkurtra ose afatgjata. Plani i pagesës afatshkurtër i Trinity Health është pa interes. Pacientët duhet tē paguajnë detyrimet e papaguara brenda një viti. Ju mund tē përfitonit një plan afatgjatë me interes nëse nuk mund tē paguani totalin e detyrimeve tē papaguara brenda një viti.

Shërbimet financiare për pacientët: Këshilluesit finanziarë janë në dispozicion për t'ju ndihmuar. Ata do t'ju ndihmojnë në plotësimin e aplikimit për asistencë financiare. Kjo do të përcaktojë se çfarë ndihme është në dispozicion. Kjo përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë për Medicaid.

Ju mund të kontaktoni një këshillues finanziar në vendin ku merrni përkujdesje. Këshilluesi finanziar mund të ndihmojë për të përcaktuar nëse kualifikoheni për ndihmë financiare. Këshilluesit finanziarë mund të ofrojnë gjithashtu kopje falas të Politikës së Asistencës Financiare, Aplikimit dhe Përbledhjes në Gjuhë të Thjeshtë.